





Center
of Excellence
in Finance

Kuantifikimi i ndikimit të reformave strukture të PRE-së

Metoda dhe shembuj



Funded by the European Union.

Fiscal Implications of Structural Reforms

Pasqyrë e përgjithshme

- 1) **Hyrje dhe vështrim i përgjithshëm mbi metodat**
- 2) Shembuj të thjeshtë - gjykimi i strukturuar i ekspertëve



Dokumenti Udhëzues i PRE-së

Pyet për ndikimin e pritur të secilës reformë në:

- **Konkurrueshmëri** - Rritja e BPV-së, eksportet, ndikimi sektorial - **të kuantifikuara** dhe të kapura nga treguesit e nivelit të lartë
- **Rezultatet sociale** - punësimi, varfëria, barazia, gjinia, qasja në kujdes shëndetësor - **cilësore ose sasore**
- **Mjedisi** - në përputhje me synimet dhe angazhimet e Marrëveshjes së Gjelbër - **të kuantifikuara**, në planin afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë

Qëllimi ynë është që t'ju inkurajojmë të bëni të paktën disa kuantifikime të disa ndikimeve - për fillim.

Procesi i kunatifikimit të ndikimit

Zhvilloni **logjikën cilësore të ndikimit** - si do të çojë masa në ndikimin e pritur (e quajtur gjithashtu 'logjika e ndërhyrjes' ose 'teoria e ndryshimit').

Shprehni masën tuaj me një '**ndryshore të ndërhyrjes**' - një ndryshore që kap efektin e menjëhershëm (p.sh. zvogëlimi i kostove admin. ose kostove financiare, shpenzimet në politikën e tregut të punës, subvencionet për bizneset).

Kuantifikoni ndikimin në terma të **ndryshimeve të pritshme të ndryshores(ve) të rezultateve** të shkaktuara nga ndryshimet në ndryshoren e ndërhyrjes.

Modelet ekonomike

Më së shpeshti zhvillohen dhe përdoren nga ministritë e financave, bankat qendrore ose institutet ekonomike.

Të dobishme për kapjen e efekteve komplekse, afatgjata dhe të rendit të dytë.

Kërkojnë aftësi të avancuara teknike

Kërkohet një komunikim i mirë midis ML-ve (njohja e masës) dhe MF-së (aftësitë teknike).

SHEMBUJ NGA PRE-TË

- KOS* - modeli i përgjithshëm i ekuilibrit që përdoret për të vlerësuar ndikimin e 4 RS-ve (eficienca e energjisë, ekonomia joformale, trajnimi i të papunëve, efikasiteti i gjykatës)
- MNE - modeli makroekonomik përdoret për të vlerësuar ndikimin e investimeve të planifikuara (por ende jo për RS-të)

Materiali mësimor në OLC:

- *përdorimi i modelit QUEST të DG ECFIN (ppt)*
- *përdorimi i **Modeli CGE KOS*** (ppt, video) për vlerësimin e ndikimit të RS-së.*

Vlerësime ekonometrike

Shembuj tipikë:

- Ndikimi i ndryshores së ndërhyrjes dhe faktorëve të tjerë në ndryshoren e rezultatit
- ‘Efekti i trajtimit’- përfituesit e masës krahasuar me një grup kontrolli

Zakonisht kap vetëm ndikimin e drejtpërdrejtë, por kërkon më pak aftësi sesa modelet dhe mund të përshtatet për masën specifike.

Çdo MF në rajon vlerëson një ‘funksion prodhimi’ si pjesë e analizës fiskale.

Materiali mësimor në OLC:

Dokumenti i DG ECFIN që vlerëson ndikimin e zvogëlimit të mospërputhjes së aftësive në produktivitet. Përfshin tregues të dobishëm të mospërputhjes së aftësive.

SUGJERIME PËR PRE-TË

Një funksion prodhimi lidh BPV-në me:

- **Kapitalin njerëzor** (fuqia punëtore e punësuar, ndonjëherë e vlerësuar sipas viteve të shkollimit)
- **Kapitalin fizik**
- **Produktivitetin shumëfaktorësh** (efektet e inovacionit, teknologjisë etj.)

Mund të përdoret për ndikimin e RS-së i cili

- rrit kapitalin njerëzor: **punësimin dhe arsimin**
- përmirëson trendin e produktivitetit: **RDI dhe digjitalizimi**



Gjykimi i strukturuar i ekspertëve

Mund të përdoret nga ekspertë në ML me njohuri të mira të fushës së politikave të tyre dhe disa aftësive për të dhënat.

Mund të kap shumë njohuri specifike në lidhje me ekonominë dhe institucionet e vendit.

Mund të perceptohet si i njëanshëm dhe naiv, por shpesh është opsioni më i mirë i mundshëm dhe më i mirë sesa pa kuantifikim.

SHEMBUJ TIPIKË

- Përshtatja e rezultateve të **studimeve ekzistuese** masës dhe vendit tuaj
- Ndërtimi i skenarit bazuar në **krahasimin** me vendet krahasuese
- Ndërtimi i skenarit bazuar në **trendet e kaluara** dhe ndryshimi që ka sjellë masa
- Transformimi i **treguesit të synimit** në ndikim të pritshëm

Pjesa tjetër e prezantimit ofron shembuj të këtyre metodave më të thjeshta

Vështrim i përgjithshëm

- 1) Hyrje dhe vështrim i përgjithshëm mbi metodat
- 2) **Shembuj të thjeshtë të gjykimit të strukturuar të ekspertëve**
 - Përshtatja e rezultateve të **studimeve ekzistuese**
 - **Krahasimi i standardeve** me vendet krahasuese
 - Ndërtimi i skenarit bazuar në **trendet e kaluara**
 - Transformimi i **treguesve të synuar** në ndikim të pritshëm

Shembull nga PRE

MASA e RS-së

Zhvillimi i infrastrukturës me brez të gjerë për ekonominë digjitale

Duke iu referuar studimit “Ndikimi i Transformimit Digjital në Ballkanin Perëndimor”, investimet në brezin e gjerë kanë mundësi të kontribuojnë në dinamikën e hapjes së vendeve të reja të punës **në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor**. Është vlerësuar se **investimet në brezin e gjerë prej 100 milionë eurosh mund të krijojnë prej 3,000 deri në 10,000 vende të reja të punës**.

Si rezultat i produktivitetit më të ulët të fuqisë punëtore (kërkohet më shumë fuqi punëtore për njësi të prodhimit), potenciali për punësim i investimeve në brezin e gjerë është më i larti **në Shqipëri**, rreth 10,000. Sipas studimit, **një stimul i kërkesës përmes 100 milionë eurove investime në brezin e gjerë do të sillte një VSHB shtesë (vlerë të shtuar bruto) deri në 0.9% në Shqipëri**.

Çfarë mund të bëhet akoma?

Ndërlidhni kuantifikimin e ndikimit me investimin aktual të planifikuar në këtë masë.



Shembull: përdorimi i vlerësimeve të ndikimit të OECD

Materiali mësimor në

OLC:

Studim i plotë i OECD-së
mbi ndikimin e RS-ve.

Policies	supply-side channel	Size of reform	OECD countries	non-OECD countries
PRODUCT MARKET REGULATION				
Product market regulation (OECD PMR indicator)	MFP	-0.58	2.27%	OECD
	K/Y	-0.58	1.55%	4.37%
	Employment	-0.58	0.99%	1.20%
Time of insolvency procedures (WB Doing Business indicator)	MFP	-1.23		10.67%
	Employment	-1.23		2.26%
LABOUR MARKET REGULATION & POLICIES				
Employment protection legislation (EPL permanent contracts)	K/Y	-0.83	3.64%	OECD
	Employment	-0.83	3.70%	2.32%
Spending on active labour market policies (ALMP)	MFP	3.18	1.27%	OECD
	Employment	3.18	0.27%	OECD
Tax wedge	Employment	-2.28	0.67%	OECD
Excess coverage (p.p.)	Employment	-1.89	0.15%	OECD
Minimum wage (% of median)	Employment	-2.48	0.70%	OECD
Unemployment benefits (% of earnings)	Employment	-1.42	0.45%	OECD
QUALITY OF INSTITUTIONS				
Rule of law	MFP	1.01	35.50%	43.4%
Cost of contract enforcement (Doing Business indicator)	MFP	-15.91		7.96%
	K/Y	-15.91		11.76%
OTHER POLICIES				
R&D investment	MFP	0.10	0.40%	OECD
Trade openness	MFP	4.01	2.80%	OECD
Corporate income tax (% of GDP)	K/Y	-0.98	1.25%	OECD



Vlerësoni ndikimin e përmirësimit të procedurave të insolvencës

- 1) Kuantifikoni reformën në terma të një ndryshoreje të përfshirë në vlerësimet e OECD-së
 - Ndryshorja: koha për procedurat e insolvencës (paaftësisë paguese) (Të Bërit Biznes, në vite)
 - Përcaktoni synimin - për shembull: të kaloni në nivelin e performuesit më të mirë në rajon, të bëni një ndryshim të ngjashëm me atë që tashmë e kanë arritur vendet e krahasueshme pyesni ekspertët se çfarë mendojnë se është e arritshme, etj. - për këtë, do të duhet të shikoni bazën e të dhënave online të Bankës Botërore mbi të bërit biznes
 - Supozoni se keni zgjedhur objektivin e shkurtimit të kohës nga 2 në 1 vit

- 2) Lexoni ndikimin e pritur nga tabela:
 - Tabela: shkurtimi për 1.23 vjet e rrit punësimin për 2.26%
 - Reforma juaj: $1/1.23$ vjet = 81% e efektit në tabelë = punësimi +1.8%
 - Kërkoni nga MF të përfshijë rritjen e punësimit në funksionin e tyre të vlerësuar të prodhimit - për të fituar ndikimin e rritjes së punësimit në BPV
 - Diskutoni nëse ndikimi në vendin tuaj ka të ngjarë të jetë më i ulët apo më i lartë


Shënim: efektet e disa ndryshoreve të tjera në tabelë shprehen me raportin kapital/ prodhim (K/Y) ose produktivitetin shumëfaktorësh (PSHFe - gjithashtu elementë të funksionit të prodhimit.



Vështrim i përgjithshëm

- 1) Hyrje dhe vështrim i përgjithshëm mbi metodat
- 2) **Shembuj të thjeshtë të gjykimit të strukturuar të ekspertëve**
 - Përshtatja e rezultateve të **studimeve ekzistuese**
 - **Krahasimi i standardeve me vendet krahasuese**
 - Ndërtimi i skenarit bazuar në **trendet e kaluara**
 - Transformimi i **treguesve të synuar** në ndikim të pritshëm

Shembull: Standardizimi në kufirin e efikasitetit



‘Kufiri i efikasitetit’ (vija e plotë) lidh vendet me kombinimin më efikas të shpenzimeve R&D (kërkim dhe zhvillim) dhe aplikacioneve për patentë për popullsi.

Kjo vijë mund të vlerësohet ose thjesht vizatohet - përdorni vende dhe mesatare të krahasueshme për disa vite.

Shigjetat tregojnë pozicionin e **Slovenisë** - me të njëjtat shpenzime, por me politika më të mira, ne mund të prodhojmë 25% më shumë aplikime për patentë.

Shumë e mirë për **debat mbi politikat** - na duhen më shumë para apo politika më të mira?

Derësoni ndikimin e rritjes së efikasitetit të shpenzimeve R&D

Si e përdori atë IMAD-i në studimin e tyre?

- Ata iu referuan studimit i cili zbuloi se një rritje prej 25% e numrit të aplikimeve për patentë shton rritjen vjetore të BPV-së me 0.1 pikë përqindjeje në planin afatgjatë (në një periudhë prej 50 vitesh) '1
- Vlerësimi i tyre i kushtëzuar: nëse e rrisim efikasitetin e shpenzimeve në nivelin e kolegëve me performancën më të mirë, BPV-ja jonë mund të rritet për 1% gjatë 10 viteve të ardhshme - e llogaritur si një efekt kumulativ i një rritjeje më të lartë ekonomike vjetore prej 0.1 p.p.

Çfarë mund të bëni:

- Së pari, natyrisht, planifikoni reformën në mënyrën më të mirë të mundshme për të rritur efikasitetin - konsultohuni me ekspertë dhe profesionistët (bizneset inovative, studiuesit e mirë)
- Vendosni një synim realist - duke krahasuar performancën tuaj me vende të krahasueshme dhe, përsëri, duke konsultuar ekspertë për realizmin e synimit tuaj
- Nga këtu, përdorni të njëjtin studim si IMAD-i për të vlerësuar ndikimin - ose edhe më mirë, gjeni studime të tjera shtesë dhe përdorni mesataren e tyre, ose rezultatin më të besueshëm

Materiali mësimor në OLC:

Studimi IMAD i cili vlerëson ndikimin e një grupi të RS-ve duke përdorur metoda të ndryshme (ppt, dokument).



Pasqyrë e përgjithshme

- 1) Hyrje dhe vështrim i përgjithshëm mbi metodat
- 2) **Shembuj të thjeshtë të gjykimit të strukturuar të ekspertëve**
 - Përshtatja e rezultateve të **studimeve ekzistuese**
 - **Krahasimi i standardeve** me vendet krahasuese
 - **Ndërtimi i skenarit bazuar në trendet e kaluara**
 - Transformimi i **treguesve të synuar** në ndikim të pritshëm

Shembull nga PRE

MASA e RS-së

Mbështetje për bizneset fillestare inovative dhe transformim digjital të kompanive

Një vlerësim i performancës së biznesit i bërë nga Projekti i Inovacionit në Serbi (IPA 2011) midis 2012 dhe 2017 zbuloi **një rritje të prekshme të të ardhurave operative nga bizneset që marrin mbështetje financiare** në këtë fushë, nga 7.7 milionë EUR në 2012 në 20.2 milionë EUR në 2017.

Shkalla e mbijetesës së bizneseve të reja inovative qëndron në një shkallë shumë të lartë 89.5%, ku 34 nga 38 ndërmarrjet e mbështetura ende ushtrojnë veprimtarinë. Nga fillimi i vitit 2016 deri në fund të vitit 2017 (pas përfundimit të programit), kompanitë e përkrahura **rritën të hyrat e tyre operative për gati 60% krahasuar me 2015** (nga 4.3 milionë EUR në 7.4 milionë EUR).

Çfarë mund të bëhet akoma?

Përdorni këto rezultate të vlerësimit të kaluar për llogaritjen e ndikimit të pritur të masës së tanishme.



Vlerësoni ndikimin e ofrimit të trajnimit për aftësi profesionale për 5% të të rinjve të papunë - bazuar në rezultatet e programeve në të kaluarën

- 1) **Mblidhni të dhëna për efektivitetin e masave të ngjashme në të kaluarën**
 - Nëse një trajnim i tillë është mbajtur në të kaluarën, sa për qind e përfituesve gjeti vend pune, të themi 6 muaj apo një vit pas trajnimit?
 - Nëse nuk janë mbledhur të dhëna të tilla, bëni një anketë në mesin e përfituesve të kaluar
 - Nëse një trajnim i tillë nuk është realizuar në të kaluarën, kërkoni të dhëna për masa të ngjashme - për shembull, ndonjë lloj trajnimi të ofruar si pjesë e politikës aktive të tregut të punës

- 2) **Bëni një varg të gjerë të llogaritjeve të mundshme “çka nëse”**
 - Çka nëse masa do të jetë aq efektive sa në të kaluarën, sa persona të trajnuar ka të ngjarë të gjejnë vende pune brenda 6 muajve pas trajnimit (dhe ta kenë atë edhe pas 1 viti)?
 - Çka nëse masa do të jetë 10% më e efektshme, sepse ju do të bëni ndryshime (reformë) në mënyrën se si ofrohet trajnimi?
 - Çka nëse masa do të jetë 10% më pak efektive, sepse sa më shumë përfitues të përfshini, aq më pak ka të ngjarë që ata ‘margjinalët’ të gjejnë vende pune?
 - Çka nëse për shkak të mungesës së fondeve ose kapacitetit institucional, ju arrini të përfshini vetëm 3% në vend të 5% të të rinjve të papunë?
 - E kështu me radhë (përdorni imagjinatën tuaj)

- 3) **Përmes diskutimit të ekspertëve, vendosni se cili rezultat i “çka nëse” është më i besueshmi dhe shpreheni, për shembull, në terma të rritjes së shkallës së punësimit të të rinjve**

Pasqyrë e përgjithshme

- 1) Hyrje dhe vështrim i përgjithshëm mbi metodat
- 2) **Shembuj të thjeshtë të gjykimit të strukturuar të ekspertëve**
 - Përshtatja e rezultateve të **studimeve ekzistuese**
 - **Krahasimi i standardeve** me vendet krahasuese
 - Ndërtimi i skenarit bazuar në **trendet e kaluara**
 - Transformimi i **treguesve të synuar** në ndikim të pritshëm

Shembull nga PRE

MASA e RS-së Ndryshimet strukturore në sektorin e bujqësisë

Indicator	Basis 2019	Intermediate target	Target 2023
Share of export of agricultural products (1-24) in total export (1-98)	17.1%	20%	23%
Share of import of agricultural products (1-24) in total import (1-98)	21.7%	18.9%	16.8%
Increase of areas with agricultural crops	21%	23%	26%

Çfarë mund të bëhet akoma?

Përdorni këto synime për pjesën e eksporteve dhe importeve edhe si një kuantifikim i ndikimit të pritur - në PRE ka mjaft masa ku treguesit mund të përdoren edhe si kuantifikim i ndikimit.

Llogaritni ndikimin e rritjes së pritshme të eksporteve bujqësore në eksportet e përgjithshme të vendit dhe rritjen e BPV-së.

Llogaritni ndikimin në PBB bazuar në treguesin e synimit

1) Llogaritni ndikimin në rritjen e eksporteve

- Supozoni se eksporti jo-bujqësor do të rritet me të njëjtën normë si në pesë vitet e kaluara; për qëllim të shembullit, të supozojmë se kjo është 5% në vit
- Llogaritni se sa duhet të rriten eksportet bujqësore për të rritur pjesën e saj nga 17.1 në 23% nga 2019 në 2023
- Rezultati është një normë e rritjes së eksporteve bujqësore prej 15.2% në vit
- E njëjta përlllogaritje po ashtu tregon se norma vjetore e rritjes së eksporteve të përgjithshme në këtë periudhë do të jetë 7.0%
- Diferenca midis kësaj rritjeje (7%) dhe rritjes në të kaluarën (5%) është kontribut i masës suaj në rritjen e përgjithshme të eksporteve
- Kështu, **duke supozuar se synimi i treguesit është realist**, ju mund të thoni **se ndikimi i masës suaj do të jetë një shtim në normën e rritjes së eksportit të vendit me 2 pikë përqindjeje**

2) Pyesni ekipin e parashikimeve makroekonomike se sa do të rris BPV-në ose normën e rritjes së BPV-së një rritje e eksporteve me 2 pikë të përqindjes

DOSJE ME LLOGARITJET PËR KËTË SHEMBULL:  Microsoft Excelov
delovni list

Disa vërejtje përfundimtare

PËRGATITUNI PËR FLEKSIBILITET DHE SHPEJTËSI

- **Baza të të dhënave** të organizuara mirë që mund tu qaseni dhe t'i përdorni shpejt
- Siguroni përcjelljen dhe transferimin e brendshëm - **mbani një regjistër të përcjelljes** së vlerësimeve të kaluara, dosjeve të të dhënave, dosjeve të programeve, shkruani shkresa të shkurtra teknike
- Zhvilloni modele/ vlerësime/ llogaritje të cilat **mund të ripërdoren lehtë**

ZHVILLONI NJË STRATEGJI PËR ZHVILLIMIN E AFTËSIVE DHE MJETEVE

- **Mendoni** për pikat e forta dhe stabilitetin e ekipit tuaj, ndihmën e mundshme teknike (projektet), dhe kërkesat/pritjet kryesore që duhet të përmbushni
- Vendosni ku të dëshironi dhe ku duhet të **përqendroni** zhvillimin e aftësive të ekipit dhe mjeteve
- **Lidhuni** me ekspertë të tjerë - bankat qendrore, institutet kërkimore, hulumtuesit - dhe zhvilloni një bashkëpunim të qëndrueshëm afatgjatë me ta

Dhe suksese!
